

KONKLUZIONE NGA TRYEZA E DISKUTIMIT ME TEMË:

QASJA GJINORE E PSIKOLOGUT NË PROCESIN E RREGULLT LIGJOR

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) në bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë zhvilloi një tryezë me temë:

Qasja gjinore e psikologut ne kuadrin e procesit te rregullt ligjor

Aktiviteti u organizua në kuadrin e projektit “*Forcimi i grave të marginalizuara përmes ofrimit të ndihmës ligjore falas dhe mbështetjes psiko-sociale, një përgjigjeje më efektive të profesionistëve dhe institucioneve, si dhe kontributit pro bono*”, i cili po zbatohet nga QNL me fonde të qeverisë suedeze nëpërmjet bashkëpunimit me Civil Rights Defenders.

Diskutimi u fokusua në lidhje me përmbushjen e konkluzioneve dhe sugjerimeve që ishin shtruar në Konferencën Shkencore kushtuar rolit dhe përmirësimit të performancës së Psikologut në organet e Drejtësisë në Shqipëri, organizuar më Janar 2015, pranë Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

E shohim të dobishme të ndajmë së bashku disa nga konkluzionet e sugjerimet e tryezës së diskutimit, në lidhje me qasjen gjinore të psikologëve që ofrojnë shërbime ose ekspertizë për dhënien e drejtësisë.

Tryeza vërejti se, disa nga konkluzionet e Konferencës të ndara me institucionet përgjegjëse gjetën zbatim në kuadrin e nismave ligjore në Reformën në Drejtësi, si dhe në krijimin e Urdhrit të Psikologut. U diskutua mbi kontributin që duhet të ofrojnë organizatat për zbatimin e legjislacionit të ri, i cili kërkon angazhime të mëtejshme për rishikimin e akteve nënligjore dhe për forcimin institucional të psikologëve që shërbejnë ose japin ekspertizë pranë organeve të drejtësisë. Për këtë është i nevojshëm referimi në standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira të vendeve të tjera, të sjella përmes studimeve shkencore.

Për sa më sipër, u vendos që QNL të bashkëpunojë me Urdhrin e Psikologut, si dhe me organizatat anëtare të Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore që ofrojnë shërbimet e psikologut, për një qasje më të ndjeshme të psikologut me dijet gjinore dhe ekspertizë korrekte nga kjo pikëpamje, përpara organeve të drejtësisë.

Konkretisht, sugjerohet:

- Të vijojë bashkëpunimi me Urdhrin e Psikologut për përgatitjen profesionale dhe qasjen gjinore të psikologut në kuadrin e zbatimit të legjislacionit të ri, në mënyrë të veçantë në

lidhje me *statusin e viktimës në procesin penal, mbrojtjen e tyre në procesin civil, me vëmendje të posaçme fëmijët, si dhe në kuadrin e ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës psikologjike falas, për këto kategori.*

- QNL në bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut, do të paraqesin pranë Ministrisë së Drejtësisë sugjerimet për përmirësimin e bazës nënligjore veçanërisht, për krijimin e regjistrit elektronik të ekspertëve, të publikimit dhe përditësimit të tij.
- QNL në bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut, do të paraqesin pranë Ministrisë së Drejtësisë sugjerimet për përmirësimin e bazës nënligjore veçanërisht, për VKM, nr. 4, datë 12.12.2012, “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”, në lidhje me kompensimin e pagesës së psikologëve që ofrojnë shërbimet falas në organet e drejtësisë.
- QNL në bashkëpunim me Urdhrin e Psikologut, do të paraqesin pranë Ministrisë së Drejtësisë sugjerimet për përmirësimin e bashkëpunimit të Psikologut me **përmbaruesin gjyqësor** në rastet e ofrimit të shërbimeve për ekzekutimin e urdhrave të mbrojtjes si dhe vendimeve të gjykatës, me qëllim mbikëqyrjen e takimeve me fëmijët, për mbrojtjen e këtyre nga dhuna.
- Urdhri i Psikologut do të bashkëpunojë me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe organizatat e rrjetit për mbarëvajtjen e trajnimeve për psikologë që operojnë në ndihmë të organeve të drejtësisë, me qëllim përgatitjen e tyre profesionale në fushën e barazisë gjinore dhe dhunës në familje, bazuar në standardet dhe doktrinën më të përparuara ndërkombëtare.
- Urdhri i Psikologut do të bashkëpunojë me QNL dhe organizatat e Rrjetit për mbarëvajtjen e bashkëpunimit të psikologëve të shkollave me organet e drejtësisë, në rastin konstatimit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj vajzave.
- Urdhri i Psikologut do të ketë në vëmendje zbatimin me një qasje të drejtë gjinore të Kodit të Etikës së Psikologut, si dhe rishikimin e tij mbi këtë bazë, në rastet e nevojshme.